



TARGET

Keep Antibiotics Working



Si të mblidhni një mostër urine me metodën e mbledhjes së pastër të urinës

Për foshnjat dhe fëmijët e vegjël


Metoda e mbledhjes së pastër të urinës

1




Lajini duart me ujë dhe sapun para dhe pas mbledhjes së mostrës.

2




Hiqeni kapakun e provëzës dhe vendoseni mbi një sipërfaqe të pastër, me pjesën e brendshme të kthyer lart.

3



Për fëmijët që e përdorin tualetin në mënyrë të pavarur, vendosuni në një pozicion të përshtatshëm që të mund të mblidhni një pjesë të urinës në provëz ndërkohë që fëmija është duke urinuar. Përpquni të mos mblidhni pikat e para të urinës dhe mblidhni mostrën nga rrjedha e mesme e urinës. Mbusheni provëzën me sa më shumë urinë që të jetë e mundur pa u derdhur, ose deri tek vija e shënuar, nëse ena ka një të tillë.

4



Shumë foshnja dhe fëmijë të vegjël urinojnë menjëherë pasi kanë pirë ose janë ushqyer. Mund të përpqeni të mblidhni një mostër gjatë kohës kur foshnja ose fëmija nuk mban pelenë, brenda një ore pas ushqyerjes.

- Mbajeni provëzën gati dhe hiqini pelenën fëmijës. Pastroni dhe thani organet gjinitale të fëmijës.
- Vendoseni fëmijën mbi një copë pëlhurë ose mbulesë që mund të lahet dhe mbajeni nën vëzhgim të vazhdueshëm.
- Kur të fillojë të urinojë, mbajeni provëzën larg lëkurës së tij/saj dhe mblidhni një pjesë të urinës.

5



Fërkimi i lehtë i zonës suprapubike (pjesa më e poshtme e barkut, në mes) me garzë ose pambuk të lagur me ujë të ftohtë mund ta nxisë fëmijën të urinojë.

6



Pasi ta keni mbledhur mostrën, vendoseni menjëherë kapakun në provëz dhe mbylleni mirë duke e shtrënguar.

7



Mos përdorni materiale thithëse, pambuk, garzë ose materiale të tjera për të mbledhur urinën, pasi ato mund të ndikojnë në rezultatet e analizës.

Udhëzime të përgjithshme

- **Pastroni dhe thani organet gjenitale të fëmijës** përpara mbledhjes së mostrës.
- **Lani gjithmonë duart** me ujë dhe sapun përpara dhe pas mbledhjes së çdo mostre urine.
- **Mos e hapni provëzën sterile** derisa të jeni gati për të mbledhur mostrën.
- **Shmangni prekjen e pjesës së brendshme të provëzës** dhe mos lejoni që organet gjenitale të fëmijës të bien në kontakt me asnjë pjesë të saj.
- Nëse profesionisti i kujdesit shëndetësor jua ka kërkuar, **vendosni etiketën në provëz** përpara mbledhjes së mostrës.

Informacion përmbledhës

Çfarë është një mostër urine e mbledhur me metodën e mbledhjes së pastër të urinës?

Një mostër e mbledhur me metodën e mbledhjes së pastër të urinës është urinë e mbledhur drejtpërdrejt në një provëz sterile, pa rënë në kontakt me lëkurën, organet gjenitale ose ndonjë sipërfaqe tjetër.

Pse duhet ta mbledh një mostër me metodën e mbledhjes së pastër të urinës?

Kjo metodë ndihmon në parandalimin e hyrjes së mikrobeve nga pjesa e jashtme e trupit në urinë, duke siguruar rezultate më të sakta të analizës.

A mund të përdor një kavanoz ose provëz nga shtëpia?

Për mbledhjen e mostrës duhet të përdorni provëzën që ju ka dhënë profesionisti juaj i kujdesit shëndetësor.

A ka rëndësi koha kur e mbledh mostrën?

Përpikuni ta mblidhni mostrën sa më afër kohës së vizitës suaj, në mënyrë që të sigurohet cilësia më e mirë e mundshme e mostrës. Përpikuni ta mblidhni mostrën përpara se fëmija të marrë antibiotikë.

Këshilla për dorëzimin e mostrës së urinës

- ✓ **Dorëzoheni mostrën sa më shpejt** Dërgojeni tek ofruesi i kujdesit shëndetësor sa më parë të jetë e mundur, mundësisht brenda dy orëve.
- ✓ **Mbajeni në temperaturë të ulët** Nëse nuk mund ta dorëzoni mostrën menjëherë, vendoseni në një qese plastike dhe ruajeni në frigorifer derisa të mund ta dorëzoni.
- ✓ **Kontrolloni orarin e pranimit të mostrave** Pyesni se deri në çfarë ore mund të dorëzohet mostra, në mënyrë që ajo të arrijë në laborator brenda së njëjtës dite.
- ✓ **Përdorimi i provëzave sterile të posaçme** Disa provëza përmbajnë një pluhur konservues dhe kanë një vijë orientuese që tregon nivelin e mbushjes. Përpikuni ta mbushni provëzën derite vija e shënuar, por nëse kjo nuk është e mundur, mblidhni sa më shumë urinë që të mundeni.

Skani këtu për më shumë informacion

